

Integrimi evropian dhe normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë

Hyrje

Më shumë se dy vite pas nënshkrimit të marrëveshjes 15-pikëshe për rikthimin e një lloji normaliteti mes tyre, Prishtina dhe Beogradi ende vazhdojnë të kenë vështirësi në implementimin e saj. E baraspeshuar me kujdes dhe shpesh e dykuptimtë, marrëveshja u ka mundur të dyja palëve të shpallin fitore. Marrëveshja i ka lejuar Beogradit ta mbajë ndikimin e tij tek serbët e Kosovës dhe të shënojë përparim të dukshëm në procesin e integritimeve evropiane, si dhe ka përmbushur qëllimin e Prishtinës për integrimin e veriut të Kosovës në kornizën e saj ligjore dhe politike. Deri më tani implementimi ka qenë i ngadalshëm dhe shumë prej pikave të marrëveshjes janë rinegociuar. Të ballafaquar me kundërshtimet e brendshme dhe trysninë nga jashtë, qeveritë e Serbisë dhe Kosovës kanë shënuar përparim gradual dhe të baraspeshuar: jo aq shumë sa për ta armiqësuar opinionin publik, por jo edhe aq pak sa për tu konsideruar si e pamjaftueshme nga ana e BE-së. Dialogu është ngushtë i lidhur me perspektivën e Kosovës dhe Serbisë për anëtarësim në BE.

Për ta adresuar çështjen e integritimit evropian të Serbisë dhe Kosovës, si dhe dialogut mes tyre, më 14 korrik të vitit 2015, CIG ka organizuar në Bruksel tryezën e tretë të rrumbullakët për një grup të vogël të zyrtarëve të lartë qeveritarë nga Kosova dhe Serbia, si dhe një numër zyrtarësh të BE-së. Tryeza e rrumbullakët është pjesë e projektit më të gjërë mbi marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë, i cili përkrahët nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës.

Përkundër përparimit në disa fusha – integrimi i serbëve në polici, zgjedhjet në veri – ende nuk është arritur marrëveshje dhe nuk ka pasur implementim të disa aspekteve më të ndjeshme, prej të cilave kryesorja mbetet krijimi i Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbë në Kosovë. Beogradi dhe serbët e Kosovës insistojnë që Asociacioni/Komuniteti të ketë fuqi thelbësore vendimmarrëse në fushën e arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban, zhvillimit ekonomik, privatizimit, si dhe kompetenca në krijimin dhe menaxhimin e ndërmarrjeve publike në komunat me shumicë serbe, me theks të veçantë në veri. Ata thonë se Asociacioni/Komuniteti është mjeti më i mirë që komuniteti serb të ndihet i sigurtë dhe të inkurajohet që të integrohet në jetën publike të Kosovës, pa pasur frikë se do të dominohen nga komuniteti shumicë.

Përfaqësuesit e Kosovës kundërshtojnë shumicën e atyre që njihen si fuqi ekzekutive për Asociacionin/Komunitetin. Ata thonë se serbët e Kosovës gëzojnë masa të mjaftueshme mbrojtëse ligjore dhe politike përmes fuqisë së rezervuar në institucionet qendrore dhe decentralizimit thelbësor i cili ka rezultuar në komuna të fuqishme. Ata thonë se Asociacioni/Komuniteti do të duhej të kishte detyra konsultative dhe koordinuese, por jo edhe fuqi vendimmarrëse. Bashkimi Evropian e lehtëson procesin dhe ka propozuar një draft statut për Asociacionin/Komunitetin, por palët ende nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje në lidhje me këtë dokument.

Pjesëmarrësit në tyre janë pajtuar se dykuptimësia e marrëveshjes, edhe pse e dobishme në fazat e para të dialogut, e ka kryer punën e saj. Ata kanë thënë se marrëveshjet duhet të jenë më specifike. Sipas disa pjesëmarrësve të afërt me procesin e negociatave kanë thënë se negociatorët e Prishtinës dhe Beogradit, të varur së tepërmi nga politika e brendshme të të dyja vendeve, nuk kanë qenë të gatshëm të nënshkruajnë dokumente të cilat do të ishin shumë specifike. Një numër i zyrtarëve ndërkombëtarë kanë thënë se bisedimet duhet të prodhojnë më shumë se sa mirëkuptim të përgjithshëm, dhe se marrëveshjet duhet poashtu të kenë dimenzionin sasior – detaje dhe afate kohore të qarta për implementimin e marrëveshjeve.

Ky raport ofron një pasqyrë të shkurtër të diskutimeve të kësaj tryeze të rrumbullakët, si dhe të disa takimeve individuale të CIG me pjesëmarrës dhe përfaqësues ndërkombëtarë. Me qëllim të inkurajimit të diskutimit të hapur, takimet e CIG organizohen nën rregullat e Chatham House, ku ato që thuhet në takim nuk u atribuohen folësve specifik.

Dialogu dhe integrimi evropian

Dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit është i ndërlidhur me perspektivën e tyre të integritit evropian. Këto dy procese mund ta ndihmojnë apo bllokojnë njëri tjetrin. Pjesëmarrësit janë pajtuar se një dialog i sukseshëm do të përshpejtonte integrimin e tyre evropian, kurse perspektiva e qartë e integritit evropian do të shërbente si nxitës për dialog dhe kompromis. Një folës nga Beogradi ka thënë se BE-ja do të duhej të ofronte një udhërrëfyes më të qartë për anëtarësimin e shteteve të Ballkanit. Deklaratat e fundit nga zyrtarët e BE-së se procesi i zgjerimit do të mbetet i ngrirë për një kohë nuk kanë ndihmuar aspak. Deklarata të tilla japin përshtypjen se pa marrë parasysh se sa të përkushtuara janë vendet e Ballkanit, ato nuk do të jenë në gjendje të anëtarësohen. Ky folës ka shtuar se ata do të ishin shumë më konstruktiv dhe të hapur ndaj kompromiseve nëse shohin gjasa më të mëdha për anëtarësim.

Beogradi dhe Prishtina janë në faza të ndryshme sa i përket procesit të integritit në BE, por megjithatë mund të bashkëpunojnë në shumë fusha. Pjesëmarrësit nga Beogradi dhe Prishtina janë pajtuar të vendosin bashkëpunimin si në nivelin politik, ashtu edhe në atë teknik mes institucioneve të Kosovës dhe Serbisë të cilat merren me integrimet evropiane. Janë identifikuar edhe një numër fushash ku mund të bashkëpunohet: bashkëpunimi në përkthimin e *acqui-së*, bashkëpunimi rreth planit të veprimit për zbatimin e *acqui-së*, si dhe në disa projekte të financuara përmes IPA-s. Pjesëmarrësit

kanë propozuar një takim mes zyrtarëve të të dy institucioneve për të shtjelluar më tej fushat në të cilat mund të bashkëpunojnë.

Një tjetër folës ka thënë se odat ekonomike të Serbisë dhe Kosovës, së bashku me Eurochambers kanë lansuar një proces ku është arritur një përparim thelbësor. Tashmë janë arritur marrëveshje mbi shërbimet postare dhe hekurudhat, ndërsa ekziston interesi i përbashkët për vendosjen e linjës së rregullt të fluturimeve mes Prishtinës e Beogradit. Ky folës ka thënë se bashkëpunimi mund të zgjerohet edhe më tej duke punuar së bashku përmes projekteve të IPA-s. Njëri nga propozimet konkrete ka qenë riparimi i tunelit hekurudhor në Merdare, në mënyrë që të mund të fillojë shërbimi i trenave mes Beogradit e Prishtinës. Një propozim tjetër ka qenë shkëmbimi i zyrtarëve ndërlidhës të ekonomisë dhe tregtisë.

Përderia pjesëmarrësit nga Kosova dhe Serbia kanë kërkuar angazhim më intensiv të BE-së në dialog, përfaqësuesit e BE-së kanë thënë se Prishtina dhe Beogradi do të duhej të mernin më shumë përgjegjësi mbi vete dhe të mbështeten më pak tek BE-ja. Kjo së pari do të tregonte se Prishtina dhe Beogradi janë të afta të zgjidhin mosmarrëveshjet mes tyre, dhe së dyti, shefja e re e politikës së jashtme të BE-së është e angazhuar në shumë çështje tjera dhe është më pak në dispozicion të çështjeve që lidhen me Ballkanin se sa paraardhësja e saj. Kriza në Ukrainë, çështjet e migrimit, Lindja e Mesme dhe negociatat me Iranin marrin pjesën më të madhe të kohës së saj. Beogradi dhe Prishtina duhet të gjejnë një mënyrë tjetër të bashkëpunimit e cila mbështetet më pak tek akterët tjerë. Një tjetër zyrtar ndërkombëtar ka thënë se motivi kryesor i Serbisë dhe Kosovës për përparim dhe zhvillim nuk do të duhej të ishte anëtarësimi në BE, por përmirësimi i jetës së qytetarëve.

BE-ja tashmë ka ofruar mjaft stimuj për Serbinë dhe Kosovën, dhe ka qenë e qartë në kërkesat e saj të cilat duhet përmbushur në mënyrë që të konsiderohet mundësia e anëtarësimit. Përfaqësuesit e BE-së kanë thënë se edhe Serbia e Kosova do të duhej të ofronin stimuj për BE-në, të tregonin se janë partnerë të denjë. Serbia dhe Kosova kanë qenë konstruktive në marrëdhëniet e tyre prej fillimit të dialogut, por BE-ja dhe shtetet anëtare janë duke pritur më shumë rezultate dhe përkushtim para hapjes së kapitujve me Serbinë. Një përfaqësues i BE-së ka thënë se BE-ja është duke u frustruar gjithnjë e më shumë. Nëse Prishtina dhe Beogradi dëshirojnë të dëshmojnë se janë akterë serioz, ata duhet të tregojnë “rezultate, e jo vetëm diskutime konstruktive”.

Serbia dhe Kosova kanë përparuar raportet e tyre të veçanta të vlerësimit mbi dialogun, dhe disa folës kanë thënë se edhe BE-ja do të duhej të hartonte raporte të tilla. Si përfaqësuesit e Beogradit, poashtu edhe ata të Prishtinës kanë thënë se një mekanizëm i tillë i vlerësimit do të ndihmonte. Pjesëmarrësit kanë thënë se BE-ja do të duhej të kishte qasje me bazë meritore në dialog, t'i shpërblejë ata të cilët bashkëpunojnë, dhe t'i ndëshkojë ata të cilët nuk bashkëpunojnë. Megjithatë, niveli i implementimit mbetet i hapur për interpretime, dhe përfaqësuesit e BE-së frikësohen se një qasje e tillë do të mund ta rrezikonte neutralitetin e tyre në rolin e ndërmjetësuesit. Përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit kanë rekomanduar që zyrtarët e BE-së të angazhohen në

interpretimin e marrëveshjeve, dhe ndonjëherë të marrin roli e arbitrit në rastet kur procesi i implementimit bllokohet.

Ka shumë të tillë, si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, që mendojnë se qytetarët nuk përfitojnë nga dialogu; ata mendojnë se politikanët janë pjesë e dialogut vetëm për shkak të trysnisë ndërkombëtare. Qytetarët do të duhej të ndjenin se dialogu është në të mirë të tyre dhe se nuk është duke u bërë vetëm për BE-në. Një folës ka thënë se ata ende janë duke u orvatur me implementimin e marrëveshjes së prillit të vitit 2013, dhe se për të fituar mbështetjen e qytetarëve të tyre, u duhet të levizin më shpejtë. Pjesëmarrësit kanë konkluduar se BE-ja duhet të jetë më e ashpër ndaj të dyja palëve, dhe të japë mesazhe më të qarta rreth implementimit dhe rreth asaj se kah është duke shkuar dialogu.

Asociacioni/Komuniteti, mekanizëm bashkues apo ndarës

Krijimi i Asociacionit/Komunitetit është çështja më kontraverze e marrëveshjes. Prishtina insiston që Asociacioni të ketë rol mbështetës dhe koordinues për punën e komunave me shumicë serbe, por jo edhe t'ua marrë atyre pushtetin. Që do të thotë, Asociacioni/Komuniteti nuk do të duhej të ketë fuqi ekzekutive. Beogradi dhe serbët e Kosovës thonë se Asociacioni/Komuniteti duhet të jetë organizatë ombrellë, me kompetenca ekzekutive në fushën e arsimit, shëndetësisë, privatizimit, zhvillimit ekonomik dhe planifikimit hapësinor, si dhe në menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Sipas ligjeve të Kosovës, këto kompetenca u përkasin autoriteteve komunale.

Krijimi i Asociacionit/Komunitetit është drejtpërdrejt i lidhur me shpërbërjen e të ashtuquajturave institucione paralele, në të cilat, sipas zyrtarëve serbë, janë ende të punësuar 5,058 persona. Ata thonë se Beogradi nuk mund ta shpërbëjë sistemin paralel pa u siguruar së pari vende pune shumicës prej tyre. Sipas një numri folësish, Beogradi më nuk është duke e përkrahur sistemin paralel – jo për shkak të arsyeve politike, por për shkak të arsyeve praktike. Largimi nga puna brenda ditës i mijëra njerëzve do të mund të krijonte një reagim të ashpër, gjë që do të shënonte një hap prapa në procesin e integritimit.

Përfaqësuesit e Kosovës kanë pranuar faktin se punësimi është çështje e rëndësishme dhe kanë thënë se kjo çështje duhet zgjidhur hap pas hapi. Ata të cilët janë të punësuar në sistemin e arsimit dhe ate shëndetësor do të mund të paguheshin nga komunat dhe buxheti i Kosovës. Kurse për të tjerët, sipas njërit nga folësit, Prishtina është e gatshme të ulet në tavolinën e bisedimeve dhe të gjejë zgjidhje.

Përfaqësuesit serbë kanë thënë se Asociacioni/Komuniteti do të mund të akomodohej brenda sistemit ligjor të Kosovës pa amandamente kushtetuese. Ata kanë thënë se qëllimi i Asociacionit/Komunitetit është përmirësimi i pozitës politike të serbëve të Kosovës. Përfaqësuesit e Kosovës mbeten skeptik sa i përket qëllimeve të Beogradit në lidhje me Asociacionin. Shumë prej tyre thonë se arsyeja e vërtetë prapa krijimit të Asociacionit/Komunitetit nuk është përmirësimi i pozitës së serbëve, por minimi i sistemit të Kosovës. Sipas një folësi, Beogradi është duke u munduar ta fusë Asociacionin/Komunitetin në kuadër të pozicionit neutral ndaj statusit. Kosova ka

institucionet qendrore dhe lokale, dhe së këndejmi, një shtresë e tretë e qeverisjes nuk mund të bëhet pjesë e kornizës së saj ligjore.

Një tjetër dallim është se serbët e shohin Asociacionin/Komunitetin si përfaqësues të tërë komunitetit serb të Kosovës, kurse shqiptarët e shohin atë si përfaqësues të komunave pjesëmarrëse. Një folës nga Kosova ka thënë se ky organ nuk mund t'i marrë kompetencat e institucioneve qendrore dhe lokale. Vendimet duhet të merren nga ata që i kanë fituar votat, e jo nga ata të cilët janë zgjedhur pa vota. Njëri nga folësit ka thënë se Asociacioni/Komuniteti nuk mund ta drejtojë arsimin dhe shëndetësinë, por ai megjithatë mund të ndihmojë. Një tjetër folës ka thënë se palët janë pajtuar rreth strukturës së Asociacionit/Komunitetit, por kompetencat mbeten ende çështje e pazgjidhur.

Pjesëmarrësit poashtu kanë diskutuar rekomandimet mbi lëvizjen para dhe implementimin e marrëveshjes së parë, rekomandime këto të cilat janë hartuar nga analistët e Kosovës dhe Serbisë në punëtorinë e organizuar nga CIG në qytetin e Arandjelovacit, rreth dhjetë ditë para takimit në Bruksel. Pjesëmarrësit e takimit në Bruksel kanë përkrahur rekomandimet, por kanë propozuar disa ndryshime të cilat janë përfshirë në verzionin e bashkangjitur në këtë raport.

Përfundimet dhe rekomandimet

- Përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit kanë propozuar organizimin e një takimi të stafit teknik dhe politik të organeve qeveritare të Kosovës e Serbisë të cilat merren me integrimet evropiane. Qëllimi i takimit do të ishte shkëmbimi i përvojave, mësimet e nxjerra, dhe bashkëpunimi në projekte, strategji dhe plane të veprimit të kërkuara nga BE-ja. Bashkëpunimi rreth përkthimit në gjuhën serbe të *acqui*-së është shembull i një fushe të bashkëpunimit. Për më shumë, ata poashtu kanë propozuar shkëmbim të stafit, një program të përbashkët edukativ mbi integrimin evropian, dhe një fushatë të përbashkët në luftimin e imazhit negativ të Ballkanit perendimor në BE.
- Serbët e Kosovës do të duhej të përfshiheshin në procesin e integritit evropian të Kosovës. Mes tjerash, integrimi evropian kërkon reforma të ndryshme në nivelin lokal, dhe kjo është njëra nga fushat ku kryetarët e komunave me shumicë serbe do të mund të angazhoheshin më shumë. Me qëllim të inkurajimit të kryetarëve të komunave me shumicë serbe që të marrin pjesë në proces, do të duhej organizuar takime të përbashkëta të përfaqësuesve të Prishtinës dhe Beogradit me kryetarët e komunave. Shumë nga folësit kanë thënë se angazhimi në procesin e integritit evropian është më pak i ndjeshëm dhe se do të mund të kishte efekt pozitiv në integrimin e serbëve të Kosovës në jetën publike të Kosovës, si dhe do të përmirësonte marrëdhëniet e përgjithshme ndëretnike.
- BE-ja, Prishtina dhe Boegradi duhet të krijojnë një mekanizëm të përbashkët i cili vlerëson rrespektimin nga ana e të gjithë akterëve të marrëveshjeve dhe afateve kohore të implementimit të dialogut të Brukselit.
- Marrëveshjet e ardhshme duhet të jenë më specifike. Paqartësia ka qenë mjaft e dobishme për inicimin e dialogut dhe arritjen e marrëveshjeve në një kohë kur përfaqësuesit e Prishtinës dhe Beogradit nuk kanë qenë të gatshëm as t'ia shtrijnë dorën njëri tjetrit. Por tani që dialogu ka lëvizur në një fazë tjetër dhe barrierat

fillestare janë eliminuar, marrëveshjet duhet të kenë specifika të qarta dhe afate kohore. Poashtu, BE-ja duhet t'i shpërblejë ata që bashkëpunojnë dhe t'i ndëshkojë të cilët nuk bashkëpunojnë. Një sistem i bazuar në merita i shpërblimeve dhe ndëshkimeve do t'i inkurajontë të dyja palët që t'u përmbahen angazhimeve të tyre. Për më shumë, BE-ja do të duhej t'u ofronte palëve një drejtim më të qartë se ku dëshiron ta shpie tërë procesin.

- Krijimi i Asociacionit/Komunitetit është proces që ndodhë së bashku me shpërbërjen e institucioneve paralele. Sipas zyrtarëve qeveritarë të Serbisë, 5,085 persona janë të punësuar në institucionet paralele. Prishtina dhe Beogradi, së bashku me serbët e Kosovës duhet të kërkojnë një zgjidhje për akomodimin e tyre.
- Me qëllim të përmirësimit të komunikimit mes dy komuniteteve në Kosovë, lënda e gjuhës shqipe duhet të futet në planprogramin e sistemit arsimor të Serbisë, dhe lënda e gjuhës serbe në atë të Kosovës.

Pjesëmarrësit

Marko Djuric, Drejtor i Zyrës për Kosovë e Metohi në Qeverinë e Serbisë

Shpetim Gashi, Nënpresident i Këshillit për Qeverisje Inkluzive

Bajram Gecaj, Zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Këshilltar i Lartë i Kryeministrit të Kosovës.

Alex Roinishvili Grigorev, President i Këshillit për Qeverisje Inkluzive

Ramadan Ilazi, Zëvendësminister i Integritimit Evropian

Ksenija Milenkovic, Drejtoreshë e Zyrës për Integrim Evropian në Qeverinë e Serbisë

Tanja Miscevic, Kryesuese e Ekipit Negociator për Hyrjen e Serbisë në Bashkimin Evropian

Mary Teresa Moran, Zëvendëskryesuese, Njësia për Kosovë, DG NEAR, Komisioni Evropian

Jean-Daniel Ruch, Ambasador i Zvicrës në Serbi

Saskia Salzmann, Këshilltarë Rajonale e Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës

Edita Tahiri, Ministre pa portofol në Qeverinë e Kosovës përgjegjëse për Dialogun me Serbinë

Dragan Vladislavljevic, Kryesues i Zyrës së Qeverisë së Serbisë për Aktivitetet Koordinuese në Procesin Negociator me Prishtinën

Catherine Wendt, Kryesuese e Njesisë për Serbinë, DG NEAR, Komisioni Evropian

Talia Wohl, Zyrtare e Progrmit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës

Zhbllokimi i implementimit të marrëveshjes së Brukselit Parime udhëheqëse dhe rekomandime

Hyrje

Më 3-4 korrik të vitit 2015, CIG ka organizuar një punëtori në Arandjelovac, Serbi, për një grup të vogël të përfaqësuesve politikë dhe analistëve nga Serbia dhe Kosova. Dita e parë e diskutimeve ka përfshirë politikanë dhe analistë. Ata i kanë adresuar sfidat rreth krijimit të një institucioni i cili i kënaq të dyja palët. Në ditën e dytë kanë marrë pjesë vetëm analistët. Bazuar në diskutimet e mëparshme, ata kanë draftuar një numër propozimesh për palët e përfshira në dialog rreth krijimit të Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe.

Dhjetë ditë më pas, më 14 korrik, këto rekomandime janë diskutuar në Bruksel, në një tryezë të vogël diskutimi me zyrtarë të lartë qeveritarë të Kosovës e Serbisë, dhe zyrtarë të BE-së, ku temat kryesore kanë qenë integrimi evropian dhe krijimi i Asociacionit/Komunitetit. Pjesëmarrësit i kanë pranuar rekomandimet dhe kanë propozuar disa ndryshime të cilat janë përfshirë në këtë verzion.

Punëtorja dhe tryeza e rumbullakët janë pjesë e projektit më të gjërë të CIG të përkrahur nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës.

Beogradi dhe Prishtina janë afër arritjes së marrëveshjes mbi Asociacionin/Komunitetin. Përfaqësuesit serbë kanë thënë se Asociacioni/Komuniteti është pjesa më e rëndësishme e marrëveshjes së Brukselit sa i përket serbëve. Një numër pjesëmarrësish kanë thënë se shumica e serbëve që jetojnë në veri janë ende kundër integritit dhe Asociacioni/Komuniteti është instrumenti i vetëm që do të mund ti bindë të integrohen. Një tjetër folës ka thënë se Asociacioni/Komuniteti do të mund të shëndërrohej në “shtytës të integritit”. Folësit nga Kosova kanë përkrahur krijimin e Asociacionit/Komunitetit, por kanë thënë se ai nuk do të duhej të kishte fuqi ekzekutive, dhe do të duhej ta plotësonte punën e komunave, e jo t’i zëvendësonte ato. Ata poashtu kanë theksuar se çka është duke kërkuar Beogradi tani për tani është që ky institucion të bëhet mjet për “segretim dhe dezintegrimit”. Një folës nga Kosova ka thënë se nëse Beogradi merr atë që e kërkon, atëherë institucionet e Kosovës do të duhej të eliminonin kompetencat e rezervuara për serbët në institucionet qendrore. Shqiptarët e Kosovës frikësohen nga kontrolli politik dhe financiar i Beogradit mbi Asociacionin. “Është e rrezikshme ti besohet drejtimi i këtij institucioni një shteti i cili ka pretendime territoriale mbi shtetin tënd”, ka thënë njëri nga pjesëmarrësit.

Parime udhëheqëse

1. Asociacioni/Komuniteti duhet të shërbejë si shtytës i integritit të serbëve të Kosovës në jetën politike dhe publike të Kosovës. Ky institucion do të duhej ta plotësonte punën e

serbëve të Kosovës në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës, e jo t'i marrë përgjegjësitë e tyre.

2. Beogradi dhe Prishtina duhet t'i bëjnë kompromiset e nevojshme për arritjen e një marrëveshjeje e cila i kënaq të dyja kryeqytetet, por e cila para së gjithash adreson brengat e komunave me shumicë serbe në Kosovë.
3. Veriu i Kosovës ka funksionuar jashtë sistemit të Kosovës për 16 vite, prandaj integrimi i tij duhet të jetë gradual dhe në faza. Krijimi i Asociacionit/Komunitetit të dhjetë komunave me shumicë serbe është një nga fazat e para drejt këtij integrimi.
4. Edhe pse Prishtina dhe Beogradi janë duke e negociuar mandatin e Asociacionit/Komunitetit, ky institucion do të duhej të ishte një organ autentik i serbëve të Kosovës. Përfaqësuesit serbë të Kosovës duhet të vendosin rreth aktiviteteve të tij dhe t'i caktojnë strukturat e tij udhëheqëse. Beogradi duhet të lejohet të ofrojë financim për Asociacionin/Komunitetin, por jo edhe ta drejtojë atë.
5. Prishtina dhe Beogradi duhet të bëhen akterë më seriozë dhe të besueshëm në procesin e dialogut, duke e përkrahur në mënyrë të vërtetë implementimin e marrëveshjeve sipas afateve kohore të parapara.
6. Prishtina dhe Beogradi, të përkrahur nga BE-ja, duhet të japin deklarata të përbashkëta pas arritjes së marrëveshjeve dhe të ofrojnë interpretime koherente para opinionit të tyre publik. Interpretimet kundërtënëse të marrëveshjeve shpeshherë kanë prodhuar huti e cila ka kontribuar që të ketë vonesa në procesin e implementimit.
7. Beogradi dhe Prishtina duhet ta ushqejnë shpirtin e dialogut dhe të vazhdojnë atë derisa të arrihet normalizimi, e jo ta përfundojnë atë atëherë kur Brukseli mendon se është arritur numër i mjaftueshëm i marrëveshjeve. Beogradi dhe Prishtina poashtu duhet të fillojnë të marrin parasysh çështjet tjera në dialog të drejtpërdrejt, pa lehtësimin ndërkombëtar. Dialogu i drejtpërdrejt Kosovë-Serbi në nivele të ndryshme qeveritare do të duhej të ndodhte më shpesh.

Rekomandime

1. Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës

- a. Të krijohet një meknizëm për udhëheqjen dhe intensifikimin e implementimit të marrëveshjes së Brukselit. Ky organ do të duhej të ishte zyre e Qeverisë së Kosovës dhe të funksionojë në bashkëpunim të drejtpërdrejt me zyrën e BE-së në Prishtinë.
- b. Të intensifikohen marrëdhëniet me publikun, kontaktet dhe komunikimi me serbët e Kosovës.
- c. Të ofrohet përkrahje e plotë për Asociacionin/Komunitetin , që ta ndihmojë në arritjen e kapaciteteve në pajtim me marrëveshjen që pritet të arrihet.
- d. Asociacioni/Komuniteti duhet të pranohet dhe të përkrahët nga Qeveria e Kosovës.
- e. Qeveria e Kosovës duhet të marrë përgjegjësinë e cila i takon komunitetit shumicë, dhe ta udhëheqë një proces gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me publikun me qëllim të transformimit të diskursit kah akomodimi më i gjërë i serbëve në Kosovë.

2. Rekomandimet për Qeverinë e Serbisë

- a. Qeveria e Serbisë duhet ti përkrahë serbët e Kosovës që të marrin më shumë përgjegjësi rreth implementimit të marrëveshjeve të arritura.

- b. Në proceset zgjedhore të ardhshme në Kosovë, Qeveria e Serbisë do të duhej të ndihmonte që të garantohet respektimi i principeve të pluralizmit demokratik për serbët e Kosovës.
- c. Qeveria e Serbisë duhet ta shohë Kosovën funksionale si diçka në interes të vetin, dhe në pajtim me këtë, ta ndryshojë diskursin publik brenda shoqërisë serbe.
- d. Me tu arritur marrëveshja për Asociacionin/Komunitetin, implementimi i saj dhe shpërbërja e institucioneve paralele duhet të ndodhin në të njëjtën kohë, në mënyrë paralele. Punësimi i rreth 5,000 personave të cilët për momentin janë të punësuar në sistemin paralel do të jetë sfida kryesore.

3. Rekomandimet për serbët e Kosovës

- a. Serbët e Kosovës duhet të kenë zë më të fuqishëm dhe angazhim më të madh në formësimin dhe implementimin e marrëveshjeve të arritura.
- b. Serbët e Kosovës duhet të jenë më proaktiv dhe të marrin më shumë përgjegjësi për implementimin e marrëveshjeve të arritura.
- c. Përfaqësuesit serbë në institucionet e Kosovës duhet të angazhohen aktivisht në procesin e implementimit të marrëveshjeve, si dhe në promovimin e të kuptuarit më mirë të procesit nga ana e komunitetit serb në Kosovë.
- d. Përfaqësuesit serbë duhet të krijojnë marrëdhënie më të mira pune përbrenda institucioneve të Kosovës, si dhe të intensifikojnë përfshirjen e tyre të përgjithshme në përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik.
- e. Serbët e Kosovës, posaçërisht ata në institucionet e Kosovës, duhet ta përkrahin tërësisht implementimin e marrëveshjeve të arritura, me theks të veçantë në marrëveshjet mbi gjykatat dhe Asociacionin/Komunitetin.

4. Rekomandime për Bashkimin Evropian

- a. BE-ja duhet të marrë një rol më proaktiv në dialog dhe në implementimin e marrëveshjeve, pra një rol më të madh se sa ate të lehtësuesit.
- b. BE-ja duhet të kontribuojë jo vetëm në normalizimin e marrëdhënieve mes qeverive, por edhe mes shoqërisë shqiptare e asaj serbe, duke përkrahur dialogjet mes shoqërive civile të Kosovës e Serbisë.
- c. BE-ja, së bashku me të dy qeveritë duhet që në mënyrë aktive të shpërndajë informata rreth sfidave dhe produkteve të dialogut, dhe ta inkurajojë popullatën që ta kuptojë drejt dhe ta përkrahë dialogun.
- d. BE-ja duhet të provojë ta bëjë dialogun e Brukselit më përfshirës duke punuar me publikun e gjërë dhe duke diskutuar normalizimin me sektorët e tjerë të shoqërive të Kosovës dhe Serbisë, duke marrë parasysh qëndrimet e tyre ndaj procesit.
- e. Kurdo që është e mundur, BE-ja duhet të ofrojë fonde për të përkrahur integrimin e veriut në institucionet e Kosovës dhe përmirësimin e perspektivës ekonomike.
- f. Plani i implementimit duhet të rivlerësohet.
- g. BE-ja duhet ta konsiderojë mundësinë e përfshirjes së pajtimit si njëra nga temat e dialogut.